

VENDIM
Nr. 775, datë 14.11.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “SKAVICË”, NË LUMIN DRIN I ZI DHE
MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË**

(Ndryshuar me VKM nr. 1436, datë 31.10.2008)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Skavicë”, në lumin Drin i Zi, nga kuota 441-285 m mbi nivelin e detit, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit *prej 4 për qind të pikëve*, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “TGK Skavica Srl”.

3. Vendimi nr.299, datë 6.5.2005 i Këshillit të Ministrave “Për fillimin e procedurës së ndërtimit me koncesion të formës “BOT”, për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, sipas propozimit të pakërkuar”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha